



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 50 dt. 22.08.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 22.08.2014, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit “Zona e mbrojtur e Kishës në Shpellë” fshati Kosharisht, Librazhd. (Shpella e Letmit)
2. Miratimin e propozimit “Zona e mbrojtur e Kishës së Shën e Premtes”, Valësh, Elbasan.
3. Miratimin e propozimit “Zona e mbrojtur e Kishës së Shën Kollit” Shelcan, Elbasan.
4. Miratimin e propozimit “Zona e mbrojtur e Kishës së Shën Gjon Vladimirit” Shijon, Elbasan.
5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI